



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE  
KUALIFIKIMEVE**

**PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN PËRFUNDIMTAR  
NË KUALIFIKIMIN PROFESIONAL “TERMOHIDRAULIKË”**

**(Niveli IV në KSHK, referuar Niveli IV në KEK)**

**TIRANË, 2024**

Në përfundim të kualifikimit profesional “**Termohidraulikë**”, **Niveli IV në KSHK, referuar Niveli IV në KEK**, individët i nënshtrohen Provimit Përfundimtar të praktikës profesionale të integruar, në zbatim të udhëzimit “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në Arsimin dhe Formimin Profesional”.

**Programi orientues** për provimet përfundimtare të kualifikimit profesional ”**Termohidraulikë**”, përmban kompetencat më të rëndësishme dhe më përfaqësuese për këtë kualifikim, të trajtuara në modulet e detyruara të praktikës profesionale në klasën e 13-të, që i përket këtij niveli.

Ky program i ndihmon individët të përqendrohen në ato kompetenca profesionale, që qëndrojnë në themel të profesionit për këtë nivel kualifikimi. Programi ndihmon, gjithashtu, edhe mësimdhënësit për organizimin e punës për përsëritjen dhe kontrollin përfundimtar të arritjeve të nxënësve.

Për drejtuesit e të gjitha niveleve, këto programe krijojnë mundësinë e verifikimit paraprak të shkallës së përgatitjes përfundimtare të individëve brenda një institucioni të caktuar shkollor, i cili mund të realizohet duke zhvilluar testime përmbledhëse.

Gjatë punës me këto programe kujdes duhet t’i kushtohet përvetësimit të njohurive dhe kompetencave themelore për këtë nivel kualifikimi, të cilat bëjnë të mundur integrimin e nxënësit/es në botën e punës, por edhe që krijojnë vazhdimësinë e shkollimit të tij/saj në shkollat e larta apo në arsimin pas të mesëm.

Gjatë përgatitjes së individëve për provimet përfundimtare, është e rëndësishme që herë pas here mësimdhënësit të zhvillojnë testime të nxënësve, me teste praktike, që mund t’i hartojnë vetë. Gjatë hartimit të përmbajtjes së tyre duhen mbajtur parasysh kompetencat e përfshira në këtë program, si edhe udhëzimet për vlerësimin e nxënësve.

### **Përmbajtja e programit për Provimin e Praktikës Profesionale të integruar**

**Programi orientues** për provimin e praktikës profesionale të integruar, në kualifikimin ”**Termohidraulikë**”, është hartuar duke u mbështetur në listën e kompetencave profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës.

**a) Lista e kompetencave profesionale** për të cilat duhet të vlerësohen nxënësit, **detyrat e punës** dhe **pikët** për secilën kompetencë:

<b>Nr</b>	<b>Kompetencat profesionale</b>	<b>Detyrat e punës</b>	<b>Pikët</b>
1.	Të interpretojë, plotësojë dhe përgatisë dokumentacionet që lidhen me instalimet hidraulike dhe termohidraulike gjatë dhe pas punimeve.	<b>Detyra 1: Plotësim dokumentacioni me programin EXCEL.</b> - ndërtim tabela punimesh me program EXCEL; - hartim lista materialesh me programin EXCEL	10
2.	Të monitorojë punimet për instalimet UK të jashtme dhe sigurimin e cilësisë për instalimet e kryera.	<b>Detyra 2: Ndjekje punimesh për instalimet UK.</b> - organizimi dhe planifikimi i punës për instalimin e linjave në UK; - kryerja punimeve përgatitore për instalime në UK; - ndjekja e punimeve për instalimin e linjave në UK,	20

		- kryerja e kontrollit të cilësisë për instalimet e kryera	
3.	Të monitorojë punimet për instalimet hidraulike brenda ndërtesës dhe sigurimin e cilësisë për instalimet e kryera.	<b>Detyra 3: Ndjekje punimesh për instalime hidraulike brenda ndërtesave.</b> - organizimi dhe planifikimi i punës për instalimin e sistemeve hidraulike brenda godinave; - kryerja e punimeve përgatitore për instalimi i sistemeve hidraulike brenda ndërtesave; - ndjekja e punimeve për instalimin e sistemeve hidraulike; - kryerja e kontrollit të cilësisë për instalimet e kryera.	25
4.	Të monitorojë punimet për instalimet termohidraulike brenda ndërtesës dhe sigurimin e cilësisë për instalimet e kryera.	<b>Detyra 4. Ndjekje punimesh për instalime termohidraulike brenda ndërtesave.</b> - organizimi dhe planifikimi i punës për instalimin e sistemeve termohidraulike; - kryerja e punimeve përgatitore për instalimi i sistemeve termohidraulike; - ndjekja e punimeve për instalimin e sistemeve termohidraulike; - kryerja e kontrollit të cilësisë për instalimet e kryera.	25
5.	Të ndjekë punimet riparuese dhe mirëmbajtëse të instalimeve hidraulike dhe termohidraulike dhe sigurimin e cilësisë për instalimet e kryera.	<b>Detyra 5. Ndjekja e punimeve riparuese dhe të mirëmbajtjes në instalime hidraulike dhe termohidraulike.</b> - organizimi dhe planifikimi i punës për riparimin e sistemeve hidraulike dhe termohidraulike; - kryerja e punimeve përgatitore për punimet riparuese të instalimeve hidraulike dhe termohidraulike; - ndjekja e punimeve për riparimin e instalimeve hidraulike dhe termohidraulike, - ndjekja e punimeve për mirëmbajtjen e sistemeve hidraulike, dhe termohidraulike. - kontrolli i cilësisë për punimet e kryera.	20
		<b>Shuma</b>	<b>100</b>

**b) Skema e vlerësimit me nota:**

<b>Pikët e fituara</b>	<b>Notat</b>
<b>0 - 40</b>	<b>4</b>
<b>41 - 50</b>	<b>5</b>
<b>51 - 60</b>	<b>6</b>
<b>61 - 70</b>	<b>7</b>
<b>71 - 80</b>	<b>8</b>
<b>81 - 90</b>	<b>9</b>
<b>91 - 100</b>	<b>10</b>

**Shënime:**

- Provimi praktik do të realizohet me anë të metodës së vlerësimit të nxënësve në “*poste pune*”, grupe pune 3-5 veta ose në mënyrë individuale, në një objekt ndërtimi, terren ose në bazën prodhuese të shkollës.
- Koha për realizimin e të gjitha detyrave duhet të jetë jo më shumë se 3 orë, në përputhje kjo me Rregulloren e Zhvillimit të Provimeve Përfundimtare në fuqi.
- Realizimi i pranueshëm i detyrave do të konsiderohet realizimi i 5 detyrave sipas standardeve e kushteve teknike, duke zbatuar rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit.
- Vlerësimi i nxënësve do të bëhet me listë kontrolli në postet e 5 detyrave duke vlerësuar hapat e realizimit për secilën nga detyrat.
- Nxënësit duhet të punojnë në mënyrë të pavarur, pa ndërhyrjen e komisionit duke u testuar/vlerësuar në një nga proceset e punës për çdo detyrë, kjo edhe për shkak të kohës së kufizuar 3 orë të provimit praktik.
- Nxënësit do të mbikëqyren gjatë gjithë kohës së përmbushjes së detyrave dhe në vlerësim, do të përfshihen edhe kompetenca kyçe të tilla, si vetëkontrolli, përgjegjshmëria, manifestimi i guximit, angazhimi fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme, marrja e vendimeve, shfrytëzimi i literaturës teknike etj.
- Në vlerësimin e kompetencave profesionale duhet t’i lihet hapësirë për vlerësim edhe bashkëbisedimit profesional ndërmjet komisionit dhe nxënësit, pasi ai është element i rëndësishëm i secilës prej kompetencave të listuara.
- Komisioni i vlerësimit për çdo detyrë duhet të përgatisë instrumentet përkatëse të vlerësimit sipas kompetencave profesionale. Instrumenti i vlerësimit për secilën detyrë duhet të përfshijë të gjitha hapat e realizimit të saj.
- Komisioni duhet të hartojë dhe një listë kriteresh vlerësimi për produktin përfundimtar.
- Komisioni duhet të përgatisë për çdo detyrë udhëzuesin e përmbushjes për nxënësit, ku do të jepen hapat për realizimin e detyrës përkatëse.

#### Udhëzime për realizimin e **detyrës 1: “Plotësim dokumentacioni me programin EXCEL”**

- ndërtim tabela punimesh me program EXCEL;
- hartim lista materialesh me programin EXCEL

Kjo detyrë do të realizohet në klasën ose laboratorin e praktikës së kompjuterëve. Mësuesi/instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të veprimeve në kompjuter për programin EXCEL (për tabelat, listat).

Nxënësit duhet të punojnë në grup ose në mënyrë individuale për realizimin e proceseve të ndërtimit dhe hartimit e tabelave me programin EXCEL deri në printimin e tyre.

Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të aftësive të çdo nxënësi.

Për realizimin si duhet të detyrës është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet si, klasë ose laborator kompjuterësh; kompjuterë personalë me programin EXCEL të instaluar; dokumentacion teknik, librezë e masave të punimeve hidraulike; video-projektor; flip-çart; markera me ngjyra; printer; formate letrash; manuale të punimeve të instalimeve hidraulike; manual i përdorimit të programit EXCEL etj.

Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara.

Vlerësimi i nxënësve bëhet më anë listës së kontrollit të përgatitur më parë.

Nxënësve do t'ju kërkohet në radhë të parë që të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit.

Udhëzime për realizimin e **detyrës 2: “Ndjekje punimesh për instalimet UK”**

Nxënësit do t'i sigurohen mjediset, mjetet dhe materialet e mëposhtme:

Mjedis pune në shkollë, ose në terren.

Materialet e nevojshme: Plan i përgjithshëm i azhornuar i instalimeve UK, plan organizim i punimeve të instalimeve UK, projekt zbatimi i projektit UK, formularë, dokumentacion teknik përkatës të instalimeve të UK, vizatime teknike, udhëzues për rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit, PMI.

Nxënësit në grupe ose në mënyrë individuale angazhohen në mënyrë konkrete, për realizimin e proceseve:

- organizimi dhe planifikimi i punës për instalimin e linjave në UK;
- kryerja e punimeve përgatitore për instalime në UK;
- ndjekja e punimeve për instalimin e linjave në UK,
- kryerja e kontrollit të cilësisë për instalimet e kryera

Gjatë vlerësimit të nxënësve, komisioni i vlerësimit duhet të verifikojë shkallën e arritjeve të shprehive praktike për realizimin e proceseve të mësipërme gjatë ndjekjes së punimeve për instalimet UK.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli, e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha kriteret e realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale, të tilla si angazhimi për realizimin e detyrës, pavarësia, kreativiteti, vetëkontrolli etj. vetëkontrolli, përgjegjshmëria, manifestimi i guximit, angazhimi fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme, marrja e vendimeve, shfrytëzimi i literaturës teknike etj.

Udhëzime për realizimin e **detyrës 3: “Ndjekje punimesh për instalime hidraulike brenda ndërtesave”**

- organizimi dhe planifikimi i punës për instalimin e sistemeve hidraulike brenda godinave;
- kryerja e punimeve përgatitore për instalimi i sistemeve hidraulike brenda ndërtesave;
- ndjekja e punimeve për instalimin e sistemeve hidraulike;
- kryerja e kontrollit të cilësisë për instalimet e kryera.

Nxënësit do t'i sigurohen mjediset, mjetet dhe materialet e mëposhtme:

Mjedis pune në shkollë, ose kompani private

Materialet e nevojshme: plan i përgjithshëm i azhornuar i objektit, planorganizim i punimeve të objektit, projektzbatim me fletët arkitektonike me detajet konstruktive të instalimeve të objektit, projektzbatimi i projektit të punimevehidraulike, formularë, dokumentacion teknik përkatës të instalimeve të sistemeve hidraulike, vizatime teknike, udhëzues për rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit, PMI.

Nxënësit në grupe ose në mënyrë individuale angazhohen në mënyrë konkrete, për realizimin e proceseve:

- organizimi dhe planifikimi i punës për instalimin e sistemeve hidraulike brenda godinave;
- kryerja e punimeve përgatitore për instalimi i sistemeve hidraulike brenda ndërtesave;
- ndjekja e punimeve për instalimin e sistemeve hidraulike;
- kryerja e kontrollit të cilësisë për instalimet e kryera.

Gjatë vlerësimit të nxënësve, komisioni i vlerësimit duhet të verifikojë shkallën e arritjeve të shprehive praktike për realizimin e proceseve të mësipërme gjatë ndjekjes së punimeve për instalimet hidraulike.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli, e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha kriteret e realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale, të tilla si angazhimi për realizimin e detyrës, pavarësia, kreativiteti, vetëkontrolli etj. vetëkontrolli, përgjegjshmëria, manifestimi i guximit, angazhimi fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme, marrja e vendimeve, shfrytëzimi i literaturës teknike etj.

#### Udhëzime për realizimin e **detyrës 4: “Ndjekje punimesh për instalime termohidraulike brenda ndërtesave”**

- organizimi dhe planifikimi i punës për instalimin e sistemeve termohidraulike;
- kryerja e punimeve përgatitore për instalimi i sistemeve termohidraulike;
- ndjekja e punimeve për instalimin e sistemeve termohidraulike;
- kryerja e kontrollit të cilësisë për instalimet e kryera.

Nxënësit do t'i sigurohen mjediset, mjetet dhe materialet e mëposhtme:

Mjedis pune në shkollë, ose kompani private, objekt ndërtimi

Materialet e nevojshme: plan i përgjithshëm i azhornuar i objektit, plan organizim i punimeve të objektit, projekt zbatim me fletët arkitektonike me detajet konstruktive të instalimeve të objektit, projekt zbatimi i projektit të punimeve termohidraulike, formularë, dokumentacion teknik përkatës të instalimeve të sistemeve termohidraulike, vizatime teknike, udhëzues për rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit, PMI.

Nxënësit në grupe ose në mënyrë individuale angazhohen në mënyrë konkrete, për realizimin e proceseve:

- organizimi dhe planifikimi i punës për instalimin e sistemeve termohidraulike
- kryerja e punimeve përgatitore për instalimi i sistemeve termohidraulike
- ndjekja e punimeve për instalimin e sistemeve termohidraulike;
- kryerja e kontrollit të cilësisë për instalimet e kryera.

Gjatë vlerësimit të nxënësve, komisioni i vlerësimit duhet të verifikojë shkallën e arritjeve të shprehive praktike për realizimin e proceseve të mësipërme gjatë ndjekjes së punimeve për instalimet termohidraulike.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli, e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha kriteret e realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale, të tilla si angazhimi për realizimin e detyrës, pavarësia, kreativiteti, vetëkontrolli etj. vetëkontrolli, përgjegjshmëria, manifestimi i guximit, angazhimi fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme, marrja e vendimeve, shfrytëzimi i literaturës teknike etj.

#### Udhëzime për realizimin e **detyrës 5: “Ndjekja e punimeve riparuese dhe të mirëmbajtjes në instalime hidraulike dhe termohidraulike”**

- organizimi dhe planifikimi i punës për riparimin e sistemeve hidraulike dhe termohidraulike;
- kryerja e punimeve përgatitore për punimet riparuese të instalimeve hidraulike dhe termohidraulike;

- ndjekja e punimeve për riparimin e instalimeve hidraulike;dhe termohidraulike,
- ndjekja e punimeve për mirëmbajtjen e sistemeve hidraulike, dhe termohidraulike.
- kontrolli i cilësisë për punimet e kryera

Nxënësit do t'i sigurohen mjediset, mjetet dhe materialet e mëposhtme:

Mjedis pune në shkollë, ose kompani private

Materialet e nevojshme: Manuale teknike të pajisjeve; formularë, dokumentacion teknik përkatës të instalimeve të sistemeve termohidraulike, vizatime teknike, udhëzues për rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit, PMI.

Nxënësit në grupe ose në mënyrë individuale angazhohen në mënyrë konkrete, për realizimin e proceseve:

- organizimi dhe planifikimi i punës për riparimin e sistemeve hidraulike dhe termohidraulike;
- kryerja punimeve përgatitore për punimet riparuese të instalimeve hidraulike dhe termohidraulike;
- ndjekja e punimeve për riparimin e instalimeve hidraulike;dhe termohidraulike,
- ndjekja e punimeve për mirëmbajtjen e sistemeve hidraulike, dhe termohidraulike.
- kontrolli i cilësisë për punimet e kryera

Gjatë vlerësimit të nxënësve, komisioni i vlerësimit duhet të verifikojë shkallën e arritjeve të shprehive praktike për realizimin e proceseve të mësipërme gjatë ndjekjes së punimeve për punimet e riparimit dhe të mirëmbajtjes.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli, e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha kriteret e realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale, të tilla si angazhimi për realizimin e detyrës, pavarësia, kreativiteti, vetëkontrolli etj. vetëkontrolli, përgjegjshmëria, manifestimi i guximit, angazhimi fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme, marrja e vendimeve, shfrytëzimi i literaturës teknike etj.